



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1026/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit “I...P...” Sh.P.K., me numër të biznesit ... dhe seli në Kaçanik, Lagjen ..., përfaqësuar sipas autorizimit nga N.R., avokat nga Kaçaniku, kundër debitorit “L...C...” Sh.P.K., me numër të biznesit ... dhe seli në ..., Komuna e Ferizaj, përfaqësuar sipas autorizimit nga J.B., avokat nga Ferizaj, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 04/21, i lejuar me datë 05.01.2021, nga Përmbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “L...C...” Sh.P.K., me numër të biznesit ..., ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 04/21, i lejuar me datë 05.01.2021, nga Përmbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 04/21, i lejuar me datë 05.01.2021, nga Përmbaruesi Privat Sheremet H. Livoreka, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm, faturës 20-SHV01-D-66, e datës 29.09.2020, ka lejuar urdhrin përmbarimor P.nr. 04/21, të datës 05.01.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 1,067.00, në emër të faturës 20-SHV01-D-66, me kamatë ligjore duke filluar nga data e parashtrimit të propozimit për përmbarim e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbarimore si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, konfrom rregullores mbi tarifatat e avokatëve.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke e kundërshtuar urdhrin përmbarimor me arsyetim se sipas praktikës afariste mes palëve,

këto të fundit obligimet e ndërsjella jo gjithëherë i kanë përmbushur me para, mirëpo përmes kompensimit me material. Ka shtuar se obligimet të cilat burojnë nga fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri debitori i ka përmbushur me zhavorr, për të cilin kreditori nuk ka paguar, pra me kompensim, fakt ky i cili vërtetohet përmes feltë-dërgesave të cilat debitori i ka ofruar kreditorit zhavorr në shumë prej EUR 1,389.00. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbarim dhe të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet për përpilimin e prapësimi dhe shpenzimet tjera të procedurës përmbarimore.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se pretendimet e debitorit se me kreditorin janë barazuar me zallë, janë të pabazuara dhe të pambështetura në prova. Ka shtuar se debitori nuk ka ofruara asnjë provë, përkatësisht transfer bankar për të dëshmuar se janë të pabazuara dhe të pambështetura në prova. Ka shtuar se fletë-dërgesat e ofruara si provë nga debitori nuk paraqesin dëshmi të barazimit apo zbatimit mes palëve. Ndërsa, gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitori, urdhri përmbarimor të vërtetohet dhe të obligohet debitori që ti bartë shpenzimet e krijuara gjatë kësaj procedure.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, paragrafi 3 i nenit 29 të LPP-së, përcakton se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm, përkatësisht faturën 20-SHV01-D-66, e datës 29.09.2020, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm në kuptim të nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është furnizuar debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Tutje, gjykata gjen se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri është i është dorëzuar me rregull debitorit i cili të njëjtën e ka pranuar dhe nënshkruar, rrjedhimisht është njoftuar me detyrimin që buron nga e njëjta.

Gjithashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përbarimor, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe e nënshkruar nga debitori.

Gjykata, gjatë vendosjes në këtë çështje përbarimore ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me pagesën e detyrimit ndaj kreditorit përmes kompensimit, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara për faktin se debitori nuk ka paraqitur prova për ti mbështetur këto pretendime, në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet.”*

Gjykata, vlerësoj edhe pretendimet e tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, por gjeti se të njëjtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së. Ndërsa, në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës gjyqësore.

Nga sa më sipër, duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1026/22, datë 28.04.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.